



BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë 11/05/2018

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë

Për: Bashkimi i operatorëve ekonomikë **1.Gentian Horjeti P.f** me NIPT **K31427013J** dhe **2.Bujari sh.p.k** me NIPT **J62904138T**.

Adresa: 1. Rruga 5 Maji, ish-Nderrmarrja Kimike, Tiranë. 2.Ura Vajgurore, Lagjja " 4 Shtatori ", Rruga " Mesi i Urave ", godine nje kateshe, Berat

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-59844-03-29-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Procedurë e hapur me objekt "Blerje materiale bojaxhiu", kohëzgjatja e kontratës deri **31.12.2018** nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: **31 666 667** (tridhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa tvsh.**

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 23.04.2018 Ora: 09:00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **Deutschcolor sh.a** me NIPT **L21326504J** me seli në Adresën: Autostrada Tirane - Durres, Km 30, godina DELTA, Durrës, me ofertë: **26 513 556** (njëzet e gjashtë milion e pesëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë pa T.v.sh.**
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë **1.Gentian Horjeti P.f** me NIPT **K31427013J** dhe **2.Bujari sh.p.k** me NIPT **J62904138T** me seli në Adresën: 1. Rruga 5 Maji, ish-

Ndërmarrja Kimike, Tiranë. 2.Ura Vajguore, Lagjja " 4 Shtatori ", Rruga " Mesi i Urave",
godine nje kateshe, Berat, me ofertë: **30 785 807** (*tridhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë
e pesë mijë e tetëqind e shtatë*) **Lekë pa T.v.sh.**

1) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se, oferta e Operatorit Ekonomik **Deutschcolor sh.a** me **NIPT L21326504J**, nuk përmban dokumentacionin e kërkuar referuar listës së kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit/kualifikimit në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914 date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik“, të cilat janë të detajuara në dokumentat standarte te tenderit.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66 pika 4, Komisioni konstatoi se, oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Gjatë shqyrtimit të ofertës së operatorit ekonomik **Deutschcolor sh.a** me **NIPT L21326504J**, KVO konstatoi se kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat operatori ekonomik **Deutschcolor sh.a** nuk i plotëson janë si më poshtë;

a) **Kriterin e veçantë për kualifikim dhe konkretisht: “Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese skedat teknike te mallrave objekt prokurimi dhe raportet e testimit nga laboratore te certifikuar sipas ISO 17025:2005 (ose ekuivalente) (per mallrat e kreut I dhe II te percaktuara ne shtojcen 12) me qellim permbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve te kerkuara per mallrat objekt prokurimi.”**

Ofertuesi Deutschcolor sh.a per permbushjen e kesaj kerkese per kualifikim ka dorezuar keto dokumenta:

1-Katalogun e kompanise prodhuese te bojrave “Deutschcolor”, si dhe te prodhuesit te materialeve te bojaxhiu “NESPOLI GROUP”

2-Çertifikate cilesie nga departamenti i laboratoreve te prodhuesit “Deutschcolor”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur konstatohet se lidhur me specifikimet teknike produktet e ofruara nuk i plotesojne specifikimet teknike te dhena ne dokumentat e tenderit dhe konkretisht:

b) **Per atikullin “Boje hidroplastike importi cilesi e I” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Alpen Classic QL11, i cili referuar faqes 8 te katalogut “Katalogu i produkteve Deutschcolor” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me :**

- *Viskozitetin, pasi ky produkt e ka viskozitetin 106 ± 2 KU 25. C nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet ne vlerat 30000 3000 cPs ne 250C*

-*Emetimin e komponenteve organike te paqendrueshme (VOC), pasi ky produkt eshte i KLASA “A/c WB” dhe VOC 39g/l nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet KLASA “A+” dhe (VOC) ne vlerat $T.V.O.C < 1000 \mu\text{g}/\text{m}^3$.*

c) **Per atikullin “ASTAR (Astar importi cilesi e I-re)” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Haftgrund”, i cili referuar faqes 32 te katalogut “Katalogu i produkteve Deutschcolor” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me:**

-*Peshen specifike, pasi ky produkt nuk e ka te shprehur peshen specifike, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet ne vlerat 1 Liter=0,900 + 10% Kg*

-*Mbulimin, pasi ky product e ka mbulimin 9 ± 1 m²/lt, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet ne vlerat >15Mq / Liter*

-*Emetimin e komponenteve organike te paqendrueshme (VOC), pasi ky produkt eshte i KLASA “A/c WB” dhe VOC 39g/l, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet KLASA “A+” dhe (VOC) ne vlerat $T.V.O.C < 1000 \mu\text{g}/\text{m}^3$*

d) Per atikullin “BOJE PLASTIKE (Boje hidroplastike importi)” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Picasso Classic VN 35”, i cili referuar faqes 22 te katalogut “Katalogu i produkteve Deutschcolor” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me :

- Rezistencen ndaj larjes, pasi ky produkt nuk e ka te shprehur rezistencen ndaj larjes, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet ne vlerat me shume se 20000 goditje furce
- Rezistencen ndaj ferkimit, pasi ky product nuk e ka te shprehur rezistencen ndaj ferkimit, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe rezistenca ndaj ferkimit te plotesoje Standartin ISO 11998.
- Aftesine mbuluese, pasi ky product nuk e ka te shprehur aftesine mbuluese, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe aftesia mbuluese te plotesoje Standartin ISO 6504-3.
- Emetimin e komponenteve organike te paqendrueshme (VOC), pasi ky produkt eshte i KLASA “A/c WB” dhe VOC 39g/l, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet KLASA “A+” dhe (VOC) ne vlerat $T.V.O.C < 1000 \mu\text{g}/\text{m}^3$
- Lidhur me rezistencen ndaj ferkimit sipas ISO 11998 ose ekuivalentin.
- Lidhur me aftesine mbuluese, ku fuqia mbuluese te jete e “KLASES 2”, sipas ISO 6504-3 ose ekuivalentin.

e) Per artikullin “PIGMENTE” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “DC Basis”, i cili referuar faqes 61 te katalogut “Katalogu i produkteve Deutschcolor” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me :

- Viskoziteti, pasi ky produkt nuk e ka te shprehur viskozitetin, nderkohe qe tek specifikimet teknike eshte percaktuar viskoziteti per secilen ngjyre pigmenti.
- Pehashi PH, pasi ky produkt nuk e ka te shprehur Pehashi PH, nderkohe qe tek specifikimet teknike eshte percaktuar Pehashi PH per secilen ngjyre pigmenti.
- Densiteti, pasi ky produkt nuk e ka te shprehur densiteti, nderkohe qe tek specifikimet teknike eshte percaktuar densiteti per secilen ngjyre pigmenti.
- Emetimin e komponenteve organike te paqendrueshme (VOC), pasi ky produkt eshte i KLASA “A/c WB” dhe VOC 39g/l, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet KLASA “A+” dhe (VOC) ne vlerat $T.V.O.C < 1000 \mu\text{g}/\text{m}^3$

e) Per artikullin “HIDROMAT” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Hidro O2”, i cili referuar faqes 46 te katalogut “Katalogu i produkteve Deutschcolor” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me :

- Viskozitetin, pasi ky produkt e ka viskozitetin $115 \pm 3 \text{ KU } 25. \text{ C}$, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet ne vlerat $32000 \pm 1800 \text{ cPs}$ ne 30°C
- Emetimin e komponenteve organike te paqendrueshme (VOC), pasi ky produkt eshte i KLASA “A/c WB” dhe VOC 39g/l, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet KLASA “A+” dhe (VOC) ne vlerat $T.V.O.C < 1000 \mu\text{g}/\text{m}^3$

f) Per artikullin “Kodar 5m” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Zgjatues teleskopik”, i cili referuar faqes 136 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me :

- Llojin e materialit nga e cila eshte bere, pasi ky produkt nuk e ka te shprehur llojin e materialit nga i cili eshte bere, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe materiali te jete alumin ose hekur i plastifikuar.
- Lidhur me numrin e hapjeve te kodarit, pasi ky produkt i ofruar ka 2 (dy) hapje, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe kodari te kete 3 (tre) hapje.
- Lidhur me gjatesine e kodarit, pasi ky produkt i ofruar e ka gjatesine max 304 cm, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe kodari te kete gjatesi max $> 5 \text{ m}$.

f)-Per artikullin “Rrula komplet per boje plastike profesional” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Rrul special per bojra murale”, i cili referuar faqes 104 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me :

-Lidhur me dimensionin e rrulit, pasi ky produkt i ofruar e ka dimensionin \varnothing 40, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe rruli te kete dimensionin \varnothing 50.

-Lidhur me gjatesine e rrulit, pasi ky produkt i ofruar nuk e ka te shprehur gjatesine, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe rruli te kete gjatesi 18-24 cm.

-Lidhur me materialin e rrulit, pasi ky produkt i ofruar nuk e ka te shprehur llojin e materialit nga i cili eshte bere, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe rruli te jete prej materiali leshti natyral.

-Lidhur me jetegjatesine e rrulit, pasi ky produkt i ofruar nuk e ka te shprehur jetegjatesine e rrulit, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe rruli te kete jetegjatesi jo me pak se 2000 m².

g)-Per artikullin “Tenie” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Tenije ECO”, i cili referuar faqes 17 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me :

-Lidhur me sasine e nje rrotulle tenije, pasi ky produkt i ofruar nuk e ka te shprehur sasine e nje rrotulle tenije, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe paketimi i tenijes te jete jo me pak se 50m.

gj)-Per artikullin “Qese mbulimi” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Pelhure e gomuar ECO”, i cili referuar faqes 14 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me :

-Lidhur me materialin e qese, pasi ky produkt i ofruar nuk e ka te shprehur llojin e materialit nga i cili eshte bere, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe qeset e mbulimit te jene prej materiali LDPE.

h) Per artikullin “Kodar 3m” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Zgjatues teleskopik”, i cili referuar faqes 136 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ploteson specifikimet teknike lidhur me:

-Llojin e materialit nga e cila eshte bere, pasi ky produkt nuk e ka te shprehur llojin e materialit nga i cili eshte bere, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe materiali te jete alumin ose hekur i plastifikuar.

-Lidhur me numrin e hapjeve te kodarit, pasi ky produkt i ofruar ka 2 (dy) hapje, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe kodari te kete 3 (tre) hapje.

-Lidhur me gjatesine e kodarit, pasi ky produkt i ofruar e ka gjatesine max 2 m, nderkohe qe tek specifikimet teknike kerkohet qe kodari te kete gjatesi max > 3 m.

i) Per artikullin “Furçe me kend” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Soft Touch”, i cili referuar faqes 85 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ploteson asnje prej specifikimet teknike te dhena ne dokumentat e tenderit.

j) Per artikullin “Furçe per boje vaji” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Special glycerol”, i cili referuar faqes 78 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ploteson asnje prej specifikimet teknike te dhena ne dokumentat e tenderit.

k) Per artikullin “Rrula komplet per boje vaji profesional” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Rrula per bojra alkide me shkelqim”, i cili referuar faqeve 108 dhe 98 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ka percaktuar (shenuar) se kush eshte rruli qe ofron.

l) Per artikullin “Furçe per lysterje me gelqere” ofertuesi “D” ka ofruar produktin “Furçe

drejtekesdeshe”, i cili referuar faqes 85 te katalogut “Catalogue Nespoli” konstatohet se nuk ploteson asnje prej specifikimet teknike te dhena ne dokumentat e tenderit.

m) Ofertuesi ka paraqitur çertifikate cilesie nga *departamenti i laboratoreve te prodhuesit “Deutschcolor”*, i cili nuk eshte laborator i certifikuar sipas ISO 17025:2005 (ose ekuivalente) (per mallrat e kreut I dhe II te percaktuara ne shtojcen 12), pasi nuk ka paraqitur asnje document qe te vertetoje se ky laborator eshte i certifikuar.

Gjithashtu ofertuesi ka paraqitur çertifikate cilesie per keto artikuj si me poshte:

- “Alpen Classic QL11”, i cili sipas ofertes teknike eshte “Boje hidroplastike importi cilesi e I”
- “Haftgrund” i cili sipas ofertes teknike eshte “ASTAR (Astar importi cilesi e I-re)”
- “Acryl Putz”, i cili sipas ofertes teknike eshte “STUKO PATINIMI”
- “Picasso Classic VN 35” i cili sipas ofertes teknike eshte “BOJE PLASTIKE (Boje hidroplastike importi)”
- “Hidro O2” i cili sipas ofertes teknike eshte “HIDROMAT”
- “Natur Kalk” i cili sipas ofertes teknike eshte “Llaç i gatshem

Nderkohe qe nuk ka paraqitur certificate cilesie nga laboratori i certifikuar per artikujt:

- “DC Basis” I cili sipas ofertes teknike eshte “Pigmente”
- “WASSERPROOF” i cili sipas ofertes teknike eshte “Kolle special kunder lageshtires”
- “Alpen Lack” i cili sipas ofertes teknike eshte “Boje zmalto”

Persa me siper ofertuesi nuk e ka permbushur kriterin per kualifikim, pasi produktet e ofruara nuk permbushin specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara ne dokumentat e tenderit, si dhe mungojne raportet e testimi nga laboratore te certifikuar, pasi raportet e testimi te paraqitura nuk jane nga laborator i certifikuar sipas ISO 17025:2005 ose ekuivalent dhe nuk jane per te gjithë artikujt e ofertuar.

n) **Kriterin e veçantë për kualifikim dhe konkretisht: Operatoret Ekonomike pjesmarres duhet te paraqesin mostrat (kampionet) ditën e hapjes se ofertave ne oren e dhe vendin e caktuar ne dokumentat e tenderit, nga jo me pak se nje 1(nje) kg (per materialet e fasadave dhe te lysterjeve te brendshme sipas kolones I dhe II te Shtojces Nr.12) dhe 1 (nje) cope (per materialet e bojaxhiut sipas kolones III te Shtojces Nr.12) per secilin prej produkteve objekt i ketij prokurimi. Per sa i takon pigmenteve dhe bojës se fasades me ngjyre te paraqiten mostrat (kampionet) per ngjyrat e percaktuara ne specifikimet teknike (shtojca nr.10).**

Lidhur me kete kriter kualifikues ju njoftojme se nuk e keni plotesuar pasi sipas process-verbalit te hapjes i mbajtur nga KVO-ja konstatohet se ju jeni paraqitur për të dorëzuar mostrat ne orën 09.25, pra 25 minuta pas hapjes se ofertave, duke mos u marre ne dorezim nga ana e KVO-se, fakt i cili eshte pasqyruar ne proces-verbal i konfirmuar nga palët.

Persa me siper ofertuesi nuk e ka permbushur kriterin per kualifikim, pasi nuk ka paraqitur mostrat e produkteve te ofruara ne oren e caktuar nga autoriteti kontraktor ashtu sikurse eshte percaktuar ne kriteret per kualifikim te dokumentave te tenderit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” si dhe kriterëve te pranim kualifikimit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **Deutschcolor sh.a** me NIPT **L21326504J**, nuk është në përputhje me kërkesat e pranim kualifikimit, **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

2) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se, oferta e Bashkimit të operatorëve ekonomikë **1.Gentian Horjeti P.f me NIPT K31427013J** dhe **2.Bujari sh.p.k me NIPT J62904138T**, *përmban dokumentacionin e kërkuar referuar listës së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të pranim/kualifikimit* në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914 date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik“, të cilat janë të detajuara në dokumentat standarte te tenderit.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66 pika 4, Komisioni konstatoi se, oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” si dhe kriterëve te pranim kualifikimit të miratuara, u konstatua se oferta e Bashkimit të operatorëve ekonomikë **1.Gentian Horjeti P.f me NIPT K31427013J** dhe **2.Bujari sh.p.k me NIPT J62904138T**, është në përputhje me kërkesat e pranim kualifikimit, **duke e shpallur ofertë të vlefshme.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e operatorëve ekonomikë **1.Gentian Horjeti P.f me NIPT K31427013J** dhe **2.Bujari sh.p.k me NIPT J62904138T** me seli ne Adresë: 1. Rruga 5 Maji, ish-Nderrmarrja Kimike, Tiranë. 2.Ura Vajgurore, Lagjja "4 Shtatori", Rruga "Mesi i Urave", godine nje kateshe, Berat, e paraqitur për tenderin me objekt “**Blerje materiale bojaxhiu**”, me afat të lëvrimit deri **31.12.2018** nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe procedura e prokurimit do të anulohet sipas të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 “Për prokurimet publike”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03/05/2018

Ankesa: S`ka pasur

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Feti Fanaj